

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7176  
E martë, 30 prill 2024  
Çmimi 0.50 €

## Kurti i kërkon Scholzit mbështetje për Këshillin e Evropës

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# QEVERIA NË VITIN E FUNDIT TË MANDATIT: A E LUFTOI KORRUPSIONIN?

FAQE 4-5




Me premtimin se do ta luftojë korrupsionin dhe do të qeverisë me duar të pastra, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga

kryeministri Albin Kurti, mori udhëheqjen në vitin 2021. Sot, në vitin e fundit të mandatit, zyrtarë të saj kritikohen për "përfshirje në

praktika korruptive pa u ndëshkuar". Së paku dy ministre janë ose nën hetime, ose në procedura gjyqësore

## AKTUALE



KIEVI THOTË SE TELEGRAMI KA BLOKUAR PROGRAMET E INTELIGJENCËS UKRAINASE F. 2

BETOHEN DHJETË VULLNETARË AMERIKANË TË KORPUSIT TË PAQES, DO TË SHËRBEJNË DY VJET NË KOSOVË F. 7

BE-JA E SHEH TAKIMIN E RADHËS PËR DINARIN SI RASTIN E FUNDIT PËR ZGJIDHJE F. 6

## EKONOMI



DHOMA E TREGTISË DHE ZËVENDËS-MINISTRI I DREJTËSISË DISKUTOJNË PËR SFIDAT E BIZNESEVE F. 8

MMPHI DHE KOMUNA E PODUJEVËS, MEMORANDUM BASHKËPUNIMI NË VLERË MBI 1 MILION EURO F. 8

## SPORT



KATËR KLUBE NDJEKIN KUPËN NË HENDBOLL F. 12

## ASK-ja: SERBËT NË VERI REZISTOJNË TË REGJISTROHEN

F. 3



NIS PETICIONI PËR PROJEKTLIGJIN PËR PARANDALIMIN E VETËVRASJES NË KOSOVË

F. 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...




## Bideni thumbon Trumpin në darkën e korrespondentëve të Shtëpisë së Bardhë

UASHINGTON, 29 PRILL - Në fjalimin mbajtur në darkën vjetore të korrespondentëve të Shtëpisë së Bardhë, presidenti amerikan Joe Biden kritikoi rivalin e tij republikan Donald Trump për papjekuri. Ai bëri shaka me moshën e tij të madhe si dhe sfidoi përfaqësuesit e medias në Uashington. "Sigurisht që mosha është problem. Jam një burrë i rritur, që po konkurron me një gjashtëvjeçar", tha Bideni, duke iu referuar rivalit të tij politik, Donald Trump. Bideni tha se ai dhe ish-presidenti Trump kanë vetëm një gjë të përbashkët, që është "mosha", përjashtuar faktin që, siç tha ai, "mua nënpresidenti im, në fakt, më mbështet". Një fjali që dukshëm u referohej marrëdhënieve të ndryshme mes Bidenit dhe

nënpresidentes Kamala Harris nga njëra anë, si dhe Trumpit e ish-nënpresidentit Mike Pence, nga ana tjetër. Në një reagim të tij në platformën "Truth Social" lidhur me darkën e korrespondentëve, Trumpi e cilësoi ngjarjen "diçka të keqe" e presidentin Biden, një fatkeqësi që nuk ka ku të shkojë më keq. Takimi u mbajt ndërsa një grup njerëzish të mbledhur jashtë ambienteve ku po zhvillohej ngjarja, protestuan kundër qëndrimeve të administratës së zotit Biden në raport me luftën në Gazë. Qindra protestues inkurajuan gazetarët ta bojkotonin aktivitetin e t'u bashkoheshin në kritikën drejtuar administratës. Bideni shmangi grumbullin e madh të njerëzve në pjesën e përparme të hotelit ku po

mbahej aktiviteti duke hyrë nga pjesa e pasme e tij, ku ndodheshin grupe më të vogla protestuesish, që bënin thirrje për armëpushim në Gazë. Darka e korrespondentëve të Shtëpisë së Bardhë, një aktivitet shekullor, bën bashkë gazetarë, politikanë dhe personalitete të jetës sociale dhe kulturore. Ajo shoqërohet shpesh me shaka e sarkazëm miqësore nga presidenti në një fjalim që ka në epiqendër gazetarët apo dhe të ftuar të tjerë që zakonisht ndodhen në audiencë. Gjatë fjalës së tij, Bideni ofroi disa këshilla për gazetarët. "Sinqerisht nuk po ju kërkoj të mbani anë, por të ngriheni në nivelin që kërkon situata aktuale. Të mos merreni me atë çfarë tregojnë sondazhet lidhur me garën apo të mos shpërqendroheni nga zhvillime



dytësore që përdoren për sensacion, por të përqendroheni tek ajo çka rrezikohet", tha presidenti Biden.

Këtë vit darka e korrespondentëve u drejtua nga komediani i emisionit të njohur satirik "Saturday Night Live", Colin Jost.

## Kryeministrja italiane Meloni shpall kandidaturën për zgjedhjet e BE-së

ROME, 29 PRILL - Kryeministrja italiane, Giorgia Meloni, ka njoftuar se do të kandidojë në zgjedhjet evropiane që mbahen në muajin qershor në një përpjekje për ta rritur mbështetjen për partinë e saj "Vëllezërit e Italisë", po ajo shtoi se nëse zgjidhet nuk do ta marrë detyrën e ligjvënësës evropiane. Zgjedhjet që mbahen prej 6 deri më 9 qershor për Parlamentin Evropian shihen si një provë kyçe për forcën që gëzon në elektorat koalicioni i saj i djathtë 18 mujor. "Ne duam të bëjmë në Evropë atë që bëmë në Itali, të krijojmë një shumicë që bashkon forcat e qendrës së djathtë e që do ta çojë të majtën në opozitë", u tha Meloni mbështetësve në një konferencë partie në qytetin bregdetar të Peskarës, nga ku dhe nisi fushatën. Meloni, partia e së cilës i ka rrënjët te grupi fashist i Benito Musolinit, bëri thirrje për daljen e Italisë nga eurozona kur ishte



opozitë dhe fitorja e saj në zgjedhjet e vitit 2022, ngriti shqetësime në disa kryeqytete evropiane. Megjithatë, ajo ka ndjekur një linjë gjerësisht pro-

evropiane gjatë qëndrimit në detyrë, veçanërisht mbi çështjet e politikës së jashtme, si Ukraina dhe Lindja e Mesme. Partia e saj gëzon mbështetjen

më të madhe popullore në Itali me 27 %, sipas sondazheve të fundit, duke kaluar Partinë Demokratike të opozitës me rreth 20 % dhe "Lëvizjen me Pesë

Yje", një formacion i majtë që gëzon 16 % mbështetje. Emri i zonjës Meloni do të jetë i pari në fletën e votimit për partinë "Vëllezërit e Italisë", në të pesë zonat zgjedhore të Italisë, por ajo u zotua se nuk do të përdorë "asnjë minutë" nga koha e saj si kryeministre për të bërë fushatë për zgjedhjet për Parlamentin Evropian. Kryetarja e Partisë Demokratike, Elly Schlein, njoftoi javën e kaluar se edhe ajo do të kandidojë gjithashtu, sikurse Antonio Tajani, kreu i partisë së qendrës "Forza Italia", një parti pjesë e koalicionit qeverisës. Të tre udhëheqësit shpresojnë t'i fitojnë votat e atyre që kanë pak interes për politikën, por që tërhiqen nga emrat e shefave të partive në fletëvotim. Duke supozuar se do të zgjidhen, si Meloni ashtu edhe Schlein e Tajani pritët të heqin dorë nga vendet e tyre, duke u hapur rrugën kandidatëve të dytë në listën e partive të tyre.

## Kievi thotë se Telegrami ka bllokuar programet e inteligjencës ukrainase

KIEV, 29 PRILL - Drejtoria kryesore e Inteligjencës e Ministrisë së Mbrojtjes së Ukrainës (HUR) thotë se platforma e mesazheve Telegram ka bllokuar një numër të "bot"-ëve zyrtarë të saj, përfshirë "chatbot"-in e inteligjencës ukrainase. "Bot"-ët janë aplikacione softuerike, të programuara për të kryer detyra të caktuara, ndërsa

"chatbot"-ët, në nivelin më bazik, janë programe të krijuara për t'i imituar bisedat që zhvillohen mes njerëzve përmes ndërveprimit me tekst apo me zë. "Sot menaxhmenti i platformës Telegram bllokoi në mënyrë të paarsyeshme një numër të 'bot'-ëve zyrtarë që kundërshtonin agresionin ushtarak të Rusisë kundër Ukrainës, duke përfshirë 'bot'-

in kryesor të inteligjencës", ka njoftuar HUR në Telegram. HUR shtoi se kjo është në kundërshtim me rregullat dhe deklaratat publike nga menaxhmenti i Telegram-it. "Me gjithë bllokimin e 'bot'-it tonë, të dhënat tuaja personale janë të sigurta", tha HUR. Lidhur me këtë nuk ka pasur asnjë reagim të menjëhershëm nga Telegram.





## Kurti i kërkon Scholzit mbështetje për Këshillin e Evropës

PRISHTINË, 29 PRILL - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka zhvilluar një bisedë telefonike me kancelarin e Gjermanisë, Olaf Scholz. Kurti ka njoftuar në platformën "X" se Gjermania e ka mbështetur dhe po mbështet Kosovën. Kryeministri ka thënë se ia ka rikonfirmuar Scholzit angazhimin për ta zbatuar plotësisht Marrëveshjen Bazë. "Në një bisedë me

kancelarin Scholz shpreha mirënjohjen për mbështetjen e vazhdueshme të Gjermanisë për Kosovën dhe nënvizova shpresën që Gjermania do ta mbështesë kandidaturën tonë në Këshillin e Evropës në përputhje me rekomandimet e PACE. Po ashtu, rikonfirmova angazhimin tonë për zbatimin e plotë të Marrëveshjes Bazë", ka

shkruar Kurti.

Ditë më parë Kurti kishte deklaruar se po punojnë që edhe Gjermania në Këshillin e Ministrave të reflektojë vullnetin e saj pozitiv edhe tek të tjerët. "Ne po e ndihmojmë Gjermaninë që të na ndihmojë neve dhe në këtë mënyrë Kosova të bëhet anëtare e 47-të e Këshillit të Evropës", kishte deklaruar Kurti.



## ASK-ja: Serbët në veri rezistojnë të regjistruhen



EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 PRILL - Kryeshefi ekzekutiv i Agjencisë së Statistikave të Kosovës, Avni Kastrati, ka thënë se serbët në katër komuna në veri të Kosovës ende po rezistojnë të regjistrohen, por jo edhe ata në gjashtë komuna në jug të Ibrit, ku po "regjistrohen në mënyrë masive". "Komuniteti serb (në veri) ende heziton në mënyrë masive", është shprehur Kastrati në një konferencë për medie në Prishtinë, në të cilën foli për ecurinë e procesit të regjistrimit të popullsisë

në Kosovë, që ka filluar më 5 prill dhe do të zgjasë deri më 17 maj. Lidhur me mospjesëmarrjen e serbëve të veriut në procesin e regjistrimit, Kastrati ka thënë se javën e kaluar janë zhvilluar bisedime me disa institucione ndërkombëtare dhe "sigurisht ata do t'ju transmetojmë atë çka u thamë ne". "Ata duhet të dinë se kjo është një e mirë edhe për ata, për ta ditur numrin e atyre që jetojnë në këto komuna. Mospjesëmarrja në regjistrim nuk ekziston", ka thënë Kastrati, duke u bërë thirrje serbëve në veri të regjistrohen. Më 5 prill, kur edhe filloi regjistrimi,

Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë e cila gëzon mbështetjen e Beogradit, kishte thënë se serbët nuk do të merrnin pjesë në procesin e regjistrimit të popullsisë. Kastrati tha se kjo thirrje e Listës Serbe është "jashtë ligjit" dhe se ASK-ja në ditët në vijim do të veprojë sipas ligjit në fuqi, duke mos thënë se çka saktësisht do të bëjë. "Kjo thirrje" ka pasur ndikim të pjesa veriore, kurse te pjesa jugore komuniteti serb është duke u regjistruar në mënyrë masive. Projekti i regjistrimit të popullsisë do të ecë përpara. Nëse komuniteti në

atë pjesë nuk merr pjesë, ne do të bëjmë një vlerësim sipas standardeve ndërkombëtare", është shprehur Kastrati. Kosova më 29 prill shënon ditën e 24-të të regjistrimit dhe, sipas Kastratit, procesi po shkon ashtu siç është planifikuar. Sipas tij, ditët e fundit është regjistruar numër më i madh i popullsisë sesa ishte e planifikuar. "Deri dje (më 29 prill) janë regjistruar më shumë se 891 000 banorë të Kosovës", deklaroi Kastrati. Kastrati u bëri thirrje qytetarëve të jenë aktivë dhe se nëse regjistruesi nuk vjen te një familje brenda këtyre

5-6 ditëve të fundit, banorët duhet ta kontaktojnë komunën e tyre për angazhimin e një ekipi. Nëse komuna nuk përgjigjet, banorët duhet ta kontaktojnë vetë ASK-në. Ai, po ashtu, tha se banorët duhet të regjistrohen aty ku kalojnë më shumë kohë gjatë një viti, jo në komunën prej nga vjen. Kastrati tha se ka mundësi që të dhënat preliminare të regjistrimit të popullsisë të publikohen në pjesën e dytë të muajit qershor. "Të dhënat do të jenë interesante dhe befasuese, sidomos te struktura e popullsisë, ndoshta edhe te mosha mesatare".

## Tahiri: Asociacioni nuk është kusht për anëtarësim në KiE

PRISHTINË, 29 PRILL - Shefi i grupit parlamentar i AAK-së, Besnik Tahiri, ka thënë se të enjten në seancë plenare do të debatohet për raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit. Në një konferencë për medie pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, Tahiri ka theksuar se për herë të parë raporti i DASH-it e targeton qeverinë si një institucion që ka probleme serioze me korrupsion. "Në këtë ditë do të debatojmë për raportin e DASH-it, për gjetjet që kanë ndodhur. Aty do të kemi një ballafaqim mes pozitës dhe

opozitës. Ajo që mund të them është se seanca e radhës e së enjtes fokusin kryesor do të ketë në raport. Raport ky që në esencë për herë të parë targeton qeverinë si një institucion i cili ka probleme serioze me çështjen e korrupsionit, mirëpo edhe me çështje të tjera. Në të njëjtën kohë kërkojmë që kryeministri të japë llogari", ka deklaruar ai. E për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, ai ka thënë se i njëjti nuk është kusht për anëtarësimin e Kosovës në

Këshillin e Evropës. Gjithashtu, ka bërë me dije se krerët e shtetit e kanë pranuar Asociacionin. "Raporti i raportueses së Kosovës për Kosovën saktëson që Kosova i ka përmbushur kushtet. Votimi ka ndodhur. Unë mendoj që Kosova e meriton ta ketë ftesën për të qenë anëtare e Këshillit të Evropës. Asociacioni në raport nuk është kusht. Qeveria duhet të ketë shumë kujdes që anëtarësimi i Kosovës është paradhoma e anëtarësimit euroatlantik", është shprehur Tahiri.







# Qeveria në vitin e fundit të mandatit: A e luftoi korrupsionin?

**PRISHTINË, 29 PRILL** - Me premtimin se do ta luftojë korrupsionin dhe do të qeverisë me duar të pastra, Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga kryeministri Albin Kurti, mori udhëheqjen në vitin 2021.

Sot, në vitin e fundit të mandatit, zyrtarë të saj kritikohen për “përfshirje në praktika korruptive pa u ndëshkuar”.

Së paku dy ministre janë ose nën hetime, ose në procedura gjyqësore.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit thotë, po ashtu, se numri i zyrtarëve publikë, që s’e kanë respektuar obligimin e deklarimit të pasurisë, është rritur në vitin 2024 krahasuar me vitin 2021, ndonëse, ndër vite, është rritur edhe numri i zyrtarëve me këtë obligim ligjor.

Vetë Qeveria e Kosovës, në anën tjetër, thotë se ka bërë “përparim” në luftimin e, siç e cilëson,

“problemit të trashëguar”.

## Rastet Gërvalla dhe Hajdari

Ministrja e Jashtme e Kosovës, Donika Gërvalla, është duke u përballur aktualisht me akuzën për mosdeklarim të pasurisë. Muajin e kaluar ajo u deklarua e pafajshme para Gjykatës Themelore në Prishtinë, por procesi është në zhvillim e sipër. Në fund të vitit 2022, ndërkaq, ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, u dënua me gjobë prej 700 eurosh nga Gjykata Themelore në Prishtinë për shkak të mosdeklarimit të pasurisë. Hajdari aktualisht është nën hetime për keqpërdorim të detyrës në lidhje me rezervat shtetërore.

E ftuar, ditë më parë, nga Prokuroria Speciale e Kosovës për intervistim, Hajdari e mbrojti veten në heshtje.

Si Hajdari ashtu edhe Gërvalla vazhdojnë t’i kryejnë detyrat ministrore.

E pyetur nga “Radio Evropa e Lirë” t’i komentojë këto raste, Qeveria e Kosovës tha në një përgjigje me shkrim se shpreh besimin se “hetimet do të vërtetojnë se nuk ka pasur asnjë shkelje apo akt korruptimi”.

## Mosdeklarimi i pasurisë

Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit në Kosovë, Yll Buleshkaj, thotë se këtë vit janë mbi 130 zyrtarë publikë që nuk e kanë deklaruar pasurinë, ose e kanë bërë këtë jashtë afatit ligjor. Sipas tij, numri i tyre është rritur për disa fish

krahasuar me vitin e kaluar. Por, thekson Buleshkaj, ngjashëm është rritur edhe numri i zyrtarëve me këtë obligim ligjor - nga rreth 4 900 në vitin 2021, në rreth 11 mijë këtë vit.

Duke folur për “Radion Evropa e Lirë”, ai tregon se si ka lëvizur numri i atyre që s’e kanë përmbushur këtë obligim ligjor ndër vite: “Në vitin 2021 kanë qenë 109 [zyrtarë]. Pastaj, ky numër ka rënë në 61 në vitin 2022 dhe në 38 në vitin 2023. Por, ky numër tani është rritur. I kemi mbi 150 [zyrtarë], të cilët nuk e kanë kryer këtë obligim këtë vit”. Buleshkaj thotë se ata zyrtarë që e kanë deklaruar pasurinë deri në 15 ditë pas afatit ligjor, do të gjobiten nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa të tjerët do të jenë subjekt i kallëzimeve penale. Kjo agjenci e ka tani kompetencën që t’i

shqiptojë vetë gjobat, të cilat, sipas Buleshkajt, sillen nga 30 për qind e pagës deri në 500 euro.

Ai thotë se këtë vit nuk ka ende ndonjë kallëzim penal për mosdeklarim të pasurisë, megjë nuk ka nisur ende procesi i verifikimit të të dhënave të mbledhura për 2024-shin.

Duke i komentuar vendimet e gjykatave për 38 rastet e vitit 2023, të cilat i ka pranuar Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Buleshkaj thotë se vlera e gjobave ka qenë prej 150 euro deri në 1.000 euro, si dhe burgim me kusht nga tre muaj deri në një vit, me kohë për verifikim deri në dy vjet.

## “Dështim në tri aspekte”

Mospërmbushja e obligimit ligjor për deklarimin e pasurisë përçon në publik mesazhin për mungesë



vullneti për të respektuar ligjin, thotë Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD). Sipas tij, Qeveria e Kosovës ka dështuar ta përmbushë premtimin për “qeverisje me duar të pastra” dhe mosdeklarimi i pasurisë paraqet “vetëm një aspekt të këtij dështimi”.

Një aspekt tjetër, thotë ai, është “kultura e pandëshkueshmërisë në rastet kur ministrat përballen me hetime penale ose parapenale”. “Dhe i treti, e ndoshta edhe më i rrezikshmi, është kur kryeministri Kurti, deputetë të Lëvizjes Vetëvendosje [partisë në pushtet], ministra... u dalin në mbrojtje personave që kanë qenë të arrestuar për korrupsion, apo subjekt i hetimeve për korrupsion”, thotë Miftaraj për “Radion Evropa e Lirë”.

Ai i referohet rastit të ministres Hajdari, atij të ambasadorit të Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, i cili aktualisht është subjekt i hetimit të Prokurorisë së Kosovës për shmangie tatimi dhe shpëlarje të parave, si dhe rastit të ish-shefit të Korporatës Energjetike të Kosovës, Nagip Krasniqi, i cili u arrestua vitin e kaluar nën dyshimin për keqpërdorim të pozitës dhe autoritetit zyrtar.

Hajdari dhe Berishaj vazhdojnë t'i kryejnë detyrat pavarësisht hetimeve, ndërsa Krasniqi, vetëm disa ditë më parë, është liruar nga detyra e drejtuesit të KEK-ut.

Mexhide Demolli, drejtore e ekzekutive e Lëvizjes FOL, e cila bën fushatë kundër korrupsionit, thotë se gjatë tre vjetëve të fundit “nuk është parë përmirësimi i premtuar” nga qeveria e

kryeministrit Kurti për luftimin e korrupsionit. “Vazhdojmë të kemi afëra korrupsionit nga ministra, ambasadorë, zyrtarë të tjerë të kësaj qeverie. Dhe, ajo që vërejmë, është një heshtje totale e kryeministrit Kurti karshi këtyre rasteve”, thotë Demolli për “Radion Evropa e Lirë”.

Sipas saj, Kurti nuk po e bën atë që ka kërkuar dikur: qeverisje me duar të pastra. “Kemi rastin e rezervave shtetërore. E kemi një ministër, që pavarësisht të gjitha atyre të dhënave që janë publikuar, vazhdon të qeverisë me mandatin e saj. Do të thotë, nuk kemi as suspendim, as largim dhe asgjë”, thotë Demolli.

Para se t'i fitonte zgjedhjet në vitin 2021, Kurti, atëkohë kandidat për kryeministër, tha për gazetën britanike Guardian se duhet një aleancë e re politike për të trajtuar “murin e madh të korrupsionit” në Kosovë. “Korrupsioni ka qenë i madh, por është shumë i përqunduar në krye. Ne besojmë se mund ta mposhtim. Shumë njerëz predikojnë tregun e lirë, por në praktikë kemi oligarkë, kartela dhe industri të rezervuara për gardën e vjetër”, tha Kurti për Guardian.

### Në shënjestër të kritikave edhe nga ndërkombëtarët

Kosova prej vitesh është në shënjestër të kritikave të institucioneve dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare për, siç thuhet, nivel të lartë korrupsionit.

Në raportin e fundit të Departamentit amerikan të

Shtetit për të drejtat e njeriut në botë, që u publikua javën e kaluar, thuhet se në Kosovë ka pasur “disa raportime për korrupsion në qeveri” dhe se “zyrtarët, nganjëherë, përfshihen në praktika korrupsive pa u ndëshkuar”.

Sipas raportit, në këtë problem kontribuojnë mungesa e mbikëqyrjes efektive gjyqësore dhe dobësia e përgjithshme në sundimin e ligjit. “Rastet e korrupsionit u nënshtrohen rregullisht apelimeve të përsëritura dhe sistemi gjyqësor shpesh lejon skadimin apo parashkrimin e lëndëve”, vlerësoi DASH-i.

Ai citoi edhe raportimet e disa mediave se Prokuroria Speciale dhe Njësia e Hetimeve Speciale të Policisë së Kosovës kanë hapur hetime penale kundër së paku pesë ministrave dhe dy zëvendësministrave, për vepra të dyshuara të lidhura me korrupsionin, por Prokuroria, e kontaktuar nga REL-i, konfirmoi vetëm rastet e lartpërmendura.

Organizata ndërkombëtare Freedom House vlerësoi në raportin e sivjetmë se korrupsioni në Kosovë vazhdon të mbetet çështje shqetësuese. “Vetë qeveria Kurti u përball me një skandal korrupsionit në vitin 2023 që përfshinte rezerva shtetërore të pallogaritura, të cilat janë ende nën hetim”, tha, mes të tjerash, Freedom House.

Derisa Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk komentoi, Qeveria e Kosovës tha në një përgjigje me shkrim për REL-in se të dyja këto raporte, në fakt, “vënë në pah një problem që është trashëguar me vite”. Ajo tha se në këto raporte “mund të

# Çka thotë Prokuroria?

Prokuroria Speciale e Kosovës konfirmon se ministrja Hajdari dyshohet se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” në lidhje me rezervat shtetërore. Ajo dyshohet se e ka dëmtuar buxhetin e Kosovës me 600 mijë euro.

Në fund të marsit, Prokuroria tha se ka intervistuar ambasadorin e Kosovës në Kroaci, Martin Berishaj, nën dyshimet për veprat penale: “shpëlarje e parave”, “shmangie nga tatimi” dhe “mosraportim ose raportim i rremë i pasurisë ose detyrimeve financiare”. Sipas Prokurorisë, Berishaj është ftuar edhe më herët për intervistim, por, me kërkesën e tij, procesi është shtyrë.

“Radio Evropa e Lirë” pyeti Prokurorinë Speciale edhe për rastin e ish-shefit të KEK-ut, Nagip Krasniqi, por ajo tha se “për shkak të ndjeshmërisë së rastit”, nuk mund të japë deklaratë lidhur me të.

vërehet progres në drejtim të luftimit të korrupsionit”, por nuk specifikoi më shumë.

Nga qeveria thanë, gjithashtu, se drafti i strategjisë së re për luftimin e korrupsionit do të dalë së shpejti në konsultim publik. “Është bërë një punë e gjatë dhe e kujdesshme. Jemi konsultuar me të gjithë aktorët relevantë, në mënyrë që të sigurojmë një proces gjithëpërfshirës, edhe pse strategjia është produkt i qeverisë dhe duhet të tregojë vizionin e saj në raport me luftimin e korrupsionit”, thuhet në deklaratën dhënë REL-it.

Miftaraj nga IKD-ja thotë se një draft për strategjinë e re, e cila përcakton objektivat e institucioneve për ta luftuar korrupsionin, është kundërshtuar nga ky institut dhjetorin e kaluar. Sipas tij, ai parashihte kontrollin

dhe mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura, si Gjykata Kushtetuese dhe Organi Shqyrtues i Prokurimit. “IKD-ja dërgoi rreth dhjetë faqe me komente, me të cilat e kishte dokumentuar qasjen e gabuar të Qeverisë. Fatmirësisht, komentet e IKD-së ishin mbështetur edhe nga partnerët ndërkombëtarë, të cilët e kishin detyruar qeverinë që ta tërhiqte atë strategji dhe të hartonte një strategji të re”, thotë Miftaraj.

Miftaraj konsideron se Kosova, aktualisht, përballlet me mungesë vullneti në dy mekanizma për ta luftuar korrupsionin: në Qeveri dhe në sistemin prokurorial.

Përderisa sistemi prokurorial mbetet i dobët, politikanët e korrumpuar motivohen për ta shkelur ligjin, duke llogaritur se mund t'ia hedhin pa pasoja, përfundon Miftaraj.





## Në shkollat e Prizrenit nisin vizitat sistematike mjekësore, Totaj e vëzhgon procesin

PRIZREN, 29 PRILL - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka vizituar shkollën "Mustafa Baku" për ta inkurajuar dhe përshëndetur personelin mjekësor dhe nxënësit në kuadër të nismës për vizita

sistematike mjekësore në shkollat e komunës së Prizrenit.

Në këtë nismë të Drejtorisë së Shëndetësisë, 6 180 nxënës të klasave I, V dhe IX do t'u nënshtrohen vizitave mjekësore, që është tregues i

një angazhimi të vazhdueshëm që arsimit në Prizren jo vetëm të jetë i përmbushur në aspektin akademik, por edhe në aspektin e kujdesit për mirëqenien dhe shëndetin e nxënësve.



## Komuna e Gjilanit njofton se nuk do të ketë ekskursione në këtë vit shkollor



GJILAN, 29 PRILL - Nxënësit e shkollave të Gjilanit kanë kërkuar të realizojnë vizita jashtë vendit edhe përkundër vendimit të kryetarit të komunës, Alban Hyseni, të 2 shkurtit, për ndalimin e tyre. Pas shpalljes së njoftimeve nga shkollat dhe pranimit të ofertave, prindërit, nxënësit dhe udhëheqësit e shkollave kanë vendosur t'i anulojnë shëtitjet për shkak të çmimeve të larta.

Drejtoresha e Arsimit e komunës së Gjilanit, Albana Demiri, ka thënë se para disa muajve kryetari Alban Hyseni ka marrë vendim për anulim të ekskursionit për maturantët jashtë vendit. Ajo tregoi se ky vendim është bërë për shumë arsye, ndër të tjera, edhe për shkak të çmimeve të papërbalueshme për prindërit, dukuritë negative të cilat kanë ndodhur në të kaluarën dhe problematika të ngjashme, të cilat për një kryetar komune të përgjegjshëm do të duhej të ishin përgjegjësi e barrë mbi supet e tij sikur tani.

Albana Demiri më tej shtoi se, pas disa takimeve me këshillin e

nxënësve e këshillat e prindërve, nxënësit kanë qenë të lirë të zgjedhin, pra të propozojnë vendin të cilin dëshirojnë ta vizitojnë.

Drejtoresha e Arsimit theksoi se secili institucion i arsimit të mesëm ka shpallur ofertë me agjendën të cilën e kanë propozuar vetë shkollat.

Pas mbylljes së afatit, duke respektuar udhëzimin administrativ në fuqi, në Drejtorinë e Arsimit janë hapur ofertat e tenderuesve sipas udhëzimit.

Më pas drejtorët e shkollave i kanë njoftuar nxënësit e shkollave për çmimet e ofruara nga kompanitë. Një pjesë e madhe e tyre kanë deklaruar se nuk janë të gatshëm të marrin pjesë në ekskursion për shkak të çmimeve. Sipas saj, këto shqetësime janë ngritur në Drejtorinë e Arsimit nga drejtorët e shkollave, me ç'rast unanimisht është marrë vendim që ekskursioni të anulohet për këtë vit shkollor. "Drejtorja e Arsimit as nuk tenderon për ekskursion, as nuk oferton për kompanitë", ka thënë drejtoresha e Arsimit, Albana Demiri.

## Policia shqipton mbi 1 300 gjoba brenda një jave në Ferizaj, konfiskon 10 patentëshoferë

FERIZAJ, 29 PRILL - Policia Rajonale e Ferizajt ka njoftuar se ka ndërmarrë një sërë aktivitete për identifikimin e kundërvajtësve të ndryshëm në komunikacion me qëllim të parandalimit të aksidenteve. "Në kuadër të këtyre aktiviteteve policia rajonale e Ferizajt gjatë javës që shkoi, nga data 22 deri më 28 prill, ka shqiptuar 1 370 gjoba kundërvajtëse, ndërsa ka hequr edhe 10 patentë shoferë për drejtuesit që kanë shkaktuar kundërvajtje më të rënda në komunikacion. Ndërsa janë raportuar 29 aksidente, prej tyre 14 aksidente janë me lëndime, 18 persona të lënduar dhe 15 aksidente me dëme materiale. Policia Rajonale e Ferizajt do të vazhdojë aktivitetet e shtuara me



synim parandalimin e aksidenteve në komunikacionin rrugor dhe apelojmë te shoferët që të bëjnë kujdes në

komunikacionin rrugor. Ftojme qytetarët të bashkëpunojnë me policinë", ka thënë njoftuar Policia e Kosovës.

## Shuajb Blakçori emërohet drejtor i Drejtorisë së Administratës në Podujevë

PODUJEVË, 29 PRILL - Me vendim të kryetarit të komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, Shuajb Blakçori është emëruar drejtori i Administratës Komunale.

Shuajb Blakçori ka përfunduar studimet në Fakultetin Ekonomik në drejtimin Banka, Financa dhe Kontabilitet, ndërsa studimet e magistraturës i ka përfunduar në drejtimin Ekonomi e Gjellbër dhe Zhvillim i Qëndrueshëm Ekonomik në South East European University. Ka punuar menaxher në përfaqësinë e "Renault" për Kosovë, menaxher në "Kosmonte Foods" si dhe analist i të dhënave statistikore në GIZ.



Kryetari Bulliqi e ka uruar Shuajb Blakçorin për detyrën e re, duke i dëshiruar suksese dhe mbarësi në kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi, si dhe i ka siguruar mbështetje dhe bashkëpunim të plotë.

## Latifi mban mbledhjen e përjavshme me drejtorët e drejtorive

RAHOVEC, 29 PRILL - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur të

hënën mbledhjen e përjavshme me drejtorët e drejtorive. Ai me drejtorët ka

biseduar për ecurinë e punëve, sfidat për zbatimin e projekteve dhe planet e

mëtejme për rritjen e mirëqenies së qytetarëve të komunës së Rahovecit.





## Instruktorë nga Turqia mbajnë trajnime me ushtarakët e Komandës së Forcave Tokësore të FSK-së

PRISHTINË, 29 PRILL - Në kuadër të bashkëpunimit me Forcat e Armatosura të Republikës së Turqisë, instruktorë turq kanë realizuar trajnime me ushtarakët e Komandës së Forcave Tokësore të regjimentit të parë dhe regjimentit të tretë, duke

ndikuar kështu në ngritjen e kapaciteteve profesionale luftarake dhe edukimin për përdorimin e sigurt të armëve: Mortaja (60 MM) dhe HAR-66. Mbështetja e vazhdueshme e partnerëve për t'i ngritur kapacitetet e FSK-së, bazuar në planin gjithëpërfshirës të tranzicionit, është e

vazhdueshme. Trajnimet dhe shkëmbimi i përvojave ndikon drejtpërdrejt në ndërveprueshmërinë me partneren. Forca e Sigurisë së Kosovës ka treguar besueshmëri dhe është e gatshme të kontribuojë në të mirë të paqes dhe sigurisë globale.



## Nis peticioni për projektligjin për parandalimin e vetëvrasjes në Kosovë

PRISHTINË, 29 PRILL - Disa organizata të shoqërisë civile kanë nisur mbledhjen e nënshkrimeve për një peticion përmes të cilit do të kërkohet hartimi i një projektligji për parandalimin e vetëvrasjes në Kosovë.

Peticioni ka nisur të hënën, më 29 prill, në qendër të Prishtinës, ndërsa nënshkrimet, përveç aty, do të mbledhen edhe në Pejë, Prizren dhe Gjakovë.

Në emër të organizatave, Bind Skeja tha se po kërkojnë një projektligj i cili do të përfshinte, ndër të tjera, shërbime klinike për parandalim të vetëvrasjes, integrim të parandalimit të vetëvrasjes në objektiva



institucionale dhe mekanizma për ngritje të profesionalizmit të medieve gjatë raportimit të vetëvrasjes.

Gjithashtu, shtoi ai, projektligji duhet të përfshijë shërbime dhe mbështetje sociale - jo klinike - për persona me mendime të

vetëvrasjes, mekanizma për reduktimin e qasjes në mjete vetëlënduese, programe specifike për komunitetet joshumicë dhe mekanizma për mbledhjen e të dhënave të vetëvrasjes.

Skeja tha se niveli institucional nuk ofron asnjë shërbim për parandalim të vetëvrasjes. "E vetmja që ofrohet janë disa ditë të mbyllur në psikiatri për trajtim pa vullnet gjë që OKB e cilëson si shkelje e të drejtave të njeriut", tha ai.

Që nga viti 2019 funksionon "Linja e Jetës" - qendër telefonike vullnetare në Kosovë që ofron ndihmë për personat që kanë mendime për

vetëvrasje, apo që vuajnë nga depresioni apo ankthi. Të gjitha të dhënat e telefonuesve mbesin konfidenciale.

Inicimi i këtij peticioni vjen duke u bazuar në Ligjin për nisma legislative, sipas të cilit, përveç presidentit, deputetëve dhe qeverisë, edhe qytetarët me të drejtë vote kanë të drejtë për nismë legislative.

Për të qenë i vlefshëm peticioni, ai duhet të nënshkruhet nga së paku 10 000 qytetarë. "Jemi të bindur që me këtë peticion jemi duke filluar një proces të pakthyeshëm të shërimit të plagëve tona komunitare", tha Skeja.

## Betohen dhjetë vullnetarë amerikanë të Korpusit të Paqes, do të shërbejnë për dy vjet në Kosovë

PRISHTINË, 29 PRILL - Dhjetë vullnetarë të rinj të Korpusit të Paqes kanë nisur detyrën e tyre në Kosovë. Ata do të shërbejnë për dy vjet në vendin tonë, ndërsa fokus do të kenë shëndetësinë, arsimin dhe pushtetin lokal.

Vullnetarët përfunduan me sukses trajnimet dhjetëjavor, të cilët mësuan gjuhën, kulturën dhe traditën.

Drejtoresha e "Peace Corps", Carlyne Siganda, ka thënë se vullnetarët vijnë prej shtatë shteteve në Amerikë të cilët do të shërbejnë në qytete të ndryshme të Kosovës si Kamenicë, Pejë, Gjilan etj.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka falënderuar ShBA-në për investimet e bëra deri më tani në Kosovë, me theks të veçantë në fushën e arsimit. "Së bashku me ambasadorin amerikan kemi marrë pjesë dhe vizituar edhe shkollat ku janë bërë investime nga fondet e ShBA-së. Ministria e Arsimit ka ndërmarrë



veprime konkrete për zhvillimin e mësimdhënësve në të gjitha komunat e vendit por edhe vullnetarët jam e bindur se do të mbesin në kujtesën e nxënësve dhe mësimdhënësve tanë", është shprehur Nagavci, duke theksuar se e çmon lart punën e secilit vullnetar që kontribuon në të mirën e nxënësve, por edhe familjeve që hapin dyert për ta.

Ndërkaq ambasadori amerikan në Kosovë, Jeffrey Hovenier, ka thënë se sot është një ditë shumë e veçantë, pasi ka nderin ta bëjë betimin e grupit të nëntë të vullnetarëve amerikanë të Korpusit të Paqes në Kosovë e për herë të parë në qytetin e Kamenicës. "I nderuar të mirëpres në Kosovë dhe të betohen vullnetarët e Grupit të 9-të të Korpusit të Paqes në Kosovë. Ju do të jeni të mirëpritur në mbi 10 komunitete anembanë Kosovës falë partneritetit me drejtorët e shkollave, organizatat joqeveritare dhe zyrtarët komunalë. Mezi pres ta shoh punën e mahnitshme që bëni të gjithë", ka thënë Hovenieri.

## Kuvendi më 2 maj debaton për raportin e DASH-it

PRISHTINË, 29 PRILL - Kuvendi i Kosovës më 2 maj do të mbajë debat parlamentar në lidhje me raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (DASH) për vendin tonë. Lajmin e ka dhënë të hënën deputeti i Vetëvendosjes, Armend

Muja, pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit. "Do të kemi seancë më dy maj, në të cilën do të diskutohet në lidhje me raportin e DASH-it dhe i cili pasohet nga votimi i marrëveshjeve ndërkom-bëtare. Vlera e këtyre marrëveshjeve ndërkom-

bëtare është 390 milionë euro të cilat janë pamundësuar për shkak të opozitës. Këto marrëveshje mbeten si teke e partive", ka thënë ai.

Raporti i DASH-it për Kosovën ka vënë në pah "korrupsionin serioz qeveritar".





# BE-ja e sheh takimin e radhës për dinarin si rastin e fundit për zgjidhje

PRISHTINË, 29 PRILL - Bashkimi Evropian pret që takimi i radhës në mes të kryenegociatorit të Kosovës dhe atij të Serbisë për çështjen e dinarit serb, të jetë rasti final për zgjidhje në bazë të propozimit të bërë nga i dërguari i posaçëm evropian për dialogun, Miroslav Lajčak. Kështu tha në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", zëdhënësi i BE-së, Peter Stano. Ai iu referua takimit të fundit në Bruksel më 25 prill mes kryenegociatorit të Kosovës, Besnik Bislimi, dhe atij të Serbisë, Petar Petković, kur nuk u arrit pajtim për transferimin e mjeteve financiare nga Serbia në Kosovë, pas vendimit të Bankës Qendrore të Kosovës që vetëm euroja të jetë valutë për kryerjen e pagesave. "Pasi të dyja palët sqaruan qëndrimet e tyre, lehtësuesi i BE-së paraqiti një propozim kompromisi për aranzhimet për një zgjidhje të përkohshme. BE-ja u bënë thirrje të dyja palëve ta pranojnë këtë propozim dhe mbetet e gatshme të jetë mikpritëse e takimit final, nëse palët angazhohen në mënyrë

konstruktive lidhur me propozimin e BE-së", tha Stano për REL-in. Takimi i radhës për këtë temë pritet të jetë pas dy javësh në Bruksel. Petković, pas takimit të fundit, tha se raundi i radhës i bisedimeve mund të mbahet më 13 maj. Pas takimit të 25 prillit, Bislimi tha se propozimi i ri i Lajçakut synon t'i përafrojë qëndrimet e palëve sa i përket ndihmës financiare nga Serbia për serbët në Kosovë. Ai nuk tregoi detaje konkrete të propozimit, por tha se Kosova dhe Serbia duhet t'i japin mendimet e tyre për të në shtatë ditët e ardhshme. "Le të themi që propozimi i sotëm është më i detajuar se ai i kaluar dhe sqaron më mirë disa prej pikave dhe vërejtjeve që ne kemi pasur në idetë e tij fillestare", deklaroi Bislimi, duke shtuar se propozimi është një përpjekje e mirë për të gjetur zgjidhje dhe se brendia kyçe e Lajçakut është të adresojë se si personat e prekur nga vendimi i BQK-së të mund të vazhdojnë të marrin ndihmë financiare nga



Serbia. Në takimet e deritashme në Bruksel për këtë çështje janë dhënë disa propozime për gjetjen e një zgjidhje, sipas së cilës, Serbia do të mund të bënte pagesa për shfrytëzuesit e ndihmës financiare në Kosovë. Me rregulloren e re të BQK-së euroja u caktua valuta e vetme në Kosovë për kryerjen e pagesave me para të gatshme nga 1 shkurti. Hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje ka zemëruar Serbinë, e cila përmes

buxhetit të saj shtetëror u dërgon ndihmë financiare serbëve që jetojnë në Kosovë. Bashkësia ndërkombëtare i ka kërkuar Kosovës ta pezullojë rregulloren në mënyrë që t'u jepet kohë qytetarëve të përshtaten me praktikën e re. Por, Qeveria e Kosovës ka ngulur këmbë se fjala është për një vendim të pavarur të BQK-së e jo për vendim politik. Ndërkaq, Stano në një konferencë për medie në Bruksel më 29 prill

hodhi poshtë kritikën se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë nuk ka pasur sukses dhe se marrëveshjet nuk po zbatohen nga palët. Ai përsëriti qëndrimin e BE-së se edhe pse Marrëveshja për rrugën drejt normalizimit dhe Aneksi për zbatimin e saj që palët arritën vitin e kaluar nuk janë nënshkruar, marrëveshjet janë ligjrisht të obligueshme për Kosovën dhe Serbinë.

Asnjëra palë ende nuk kanë bërë hapa drejt zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Kosova, po ashtu, kritikohet se nuk ka nisur themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, ndërkaq Serbia kritikohet për hapat që po ndërmer për ta penguar anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare, përfshirë edhe procesin aktual të anëtarësimit në Këshillin e Evropës. Mes të tjerash, marrëveshja e arritur vitin e kaluar thotë se Serbia nuk do ta kundërshtojë anëtarësimin e Kosovës në asnjë organizatë ndërkombëtare.

## Dhoma e Tregtisë dhe zëvendësministri i Drejtësisë diskutojnë për sfidat e bizneseve

**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 PRILL - Problemet e bizneseve me procedurat e përmbarimit, numri i ulët i gjykatësve si dhe vonesat në trajtim të rasteve në Gjykatën Komerciale ishin disa nga çështjet e diskutuara në takimin e realizuar ndërmjet përfaqësuesve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë me zëvendësministrin e Drejtësisë, Blerim Sallahu.

Zana Beqiri, drejtore e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, ka falënderuar zëvendësministrin Sallahu për takimin dhe ka bërë me dije se një ndër ankesat është ajo e mosfunksionimit të përmbaruesve si rrjedhojë e mundësisë së ankesës në gjykatë nga ana e bizneseve, anë pse ekziston si dëshmi kontrata dhe fatura e rregullt e nënshkruar nga po ata. Ndërsa sipas Mazllum Baraliu,



konsulent në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, vlerë e shtuar për DHTIK-në është komuniteti i bizneseve që

përfaqëson. Prandaj, sipas tij, është më se e nevojshme që të përfshihet në grupet punuese për Projektligjin për Përmbarim, ashtu

që në draftin final të merren në konsideratë dhe të përfshihen edhe komentet e bizneseve vendore.

Ai shtoi se Dhoma e Tregtisë që në fazën e hartimit të Ligjit për Gjykatën Komerciale ka rekomanduar që duhet të parashihet numër më i madh i gjykatësve, mungesa e të cilëve sot po ndikon që lëndët e kësaj gjykate të kenë dinamikë të ulët të trajtimit. Zëvendësministri i Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka theksuar se bashkëpunimi me komunitetin e bizneseve është i domosdoshëm, sepse vetëm në këtë mënyrë do të sigurohet që draftet finale të ligjeve të jenë gjithëpërfshirëse.

Sipas zëvendësministrit Sallahu, Ministria e Drejtësisë është duke trajtuar këto çështje, me theks të veçantë problemim e përmbaruesve, ndërsa për rastet e shumta dhe të patrajtuara në Gjykatën Komerciale shtoi që aktualisht është duke u finalizuar Ligji për Gjykatën Administrative e që në mënyrë direkte do të ndikojë në uljen e rasteve të Gjykatës Komerciale.

## MMPHI dhe komuna e Podujevës, memorandum bashkëpunimi në vlerë mbi 1 milion euro

PODUJEVË, 29 PRILL - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, bashkë me ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Liburn Aliu, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimit në vlerë mbi 1 milion euro. Në këtë takim të pranishëm ishin edhe zëvendësministri i MMPHI-së, Hysen Durmishi dhe drejtorë të ekzekutivit komunal.

Ky memorandum bashkëpunimi përfshin rikonstruimin dhe rehabilitimin e rrugës "Dëshmorët Babatinca" në vlerë prej 537 mijë eurosh. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse Sfeçël - Dumosh në vlerë prej 159 mijë eurosh. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse Bradash - Dobratin në vlerë financiare 155,500.00 euro. Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës lidhëse nga gurthyesi

deri në rrugën "Sahit Llallosi" në vlerë prej 185,150.00 eurosh. Pas nënshkrimit të marrëveshjes, kryetari Bulliqi, bashkë me ministrin Aliu dhe zëvendësministrin Durmishi, vizituan nga afër punimet që po realizohen në terren dhe ato që do të realizohen në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.





# Të rinjtë nuk kanë çfarë të shpresojnë!



Nga: Yasmin RUFO / BBC  
Përkthimi: Telegrafi.com

Për novelistin Hanif Kureishi, gjithë rritja në vitet 1970 ishte e mbushur me shpresë dhe optimizëm – ndjenja të dokumentuara mirë në romanin e tij gjysmë-autobiografik, Buda i periferisë [The Buddha of Suburbia].

Tani, mbi 30 vjet pas botimit të librit të tij, Buda i periferisë po përshtatet për skenën teatrale dhe Kureishi, së bashku me regjisoren Emma Rice, kanë reflektuar për një nga temat kryesore të librit.

“Ishte ndjenja se mund të bëje gjithçka ose të jesh kushdo”, thotë 69-vjeçari Kureishi, teksa mendon për fëmijërinë e vet. “Racizmi ishte padyshim më i dukshëm sesa sot, por ende ishte ajo ndjenja e optimizmit – në fakt ishte epoka e fundit kur njerëzit shpresonin për të ardhmen”.

Kureishi fitoi famë për herë të parë në vitin 1985, kur skenari i tij Lavanderia ime e bukur [My Beautiful Laundrette] – për marrëdhënien midis një djali britanik pakistanez dhe të dashurit të tij të bardhë – u nominua për një çmim Bafta dhe për një çmim Oscar.

Kur mendon se sa e ndryshme ishte fëmijëria e tij nga ajo e djemve të tij, thotë se është “e trishtueshme që të rinjtë nuk kanë më shpresë”.

“Shpresa nuk është ëndërr boshe, kjo do të thotë se në botë ekziston mundësia se ajo që dëshiron mund të ndodhë, dhe fëmijët e mi nuk mendojnë se do të jenë në gjendje të blejnë shtëpi ose të gjejnë punë fitimprurëse”, shpjegon ai.

Dëshpërimi i njerëzve për shpresë është ajo që e shtyu Ema Ricein të sillte në skenë Budën e periferisë. “Shfaqja jonë ua jep njerëzve atë shpresë, tregon se ne të gjithë mund të jetojmë së bashku dhe të jemi të lumtur”.

Buda i periferisë është vendosur në vitet 1970 dhe tregon historinë e 17-vjeçarit Karim i cili, në sfondin e dimrit të pakënaqësisë, është i detyruar të shpëtojë nga periferia për t’u zhytur në mundësitë emocionuese që ofron Londra.

I botuar për herë të parë në vitin 1990, e fitoi çmimin “Whitbread” për librin e vitit dhe tre vjet më vonë u adaptua nga BBC për një seri televizive me katër episode. Tani është duke u realizuar për skenë nga Trupa Mbretërore e Shekspirin dhe do të shfaqet për gjashtë javë në Stretford në Ejvon. Për Ricein, shfaqja ka të bëjë me eksplorimin e familjes, miqve, seksit, teatrit dhe përkatësisë.

Është gjithashtu një “shënim i viteve 1970, veçanërisht i muzikës dhe modës”, kështu që mjedisi nuk është modernizuar.

Ruajtja e muzikës origjinale, modës dhe historisë të vendosur shumë dekada më parë, mund të

përcillet me rrezikun që të ndihet e vjetruar.

Vitin e kaluar u dha version filmik i romanit klasik të Judy Blumeit, Zot, a Je aty? Jam unë, Margarita [Are You There God? It’s Me, Margaret]. Botuar fillimisht në vitet 1970, rrëfimi që flet për një vajzë në prag të adoleshencës, e cila është në ankth për pubertetin dhe moshën madhore, u prit me komente të ndryshme – një përmbledhje me tre yje nga Peter Bradshaw në The Guardian tha se “ndihet paksa i vjetruar” dhe se “luhet si një pjesë historike e viteve 1970, në vend që të përditësohet për botën moderne”.

Por, as Kureishi dhe as Rice nuk janë të shqetësuar për këtë.

“Nuk jam i interesuar të jem i rëndësishëm sot”, thotë Kureishi, por pranon se rrëfimi ka ende rëndësi kulturore për audiencën e sotme dhe se ka gjasa të tërheq të rinjtë.

“Ka pasur gjithmonë një luftë për ta nxjerr teatrin nga getoja e klasës së mesme, por me të vërtetë mendoj se të rinjtë do të jenë të interesuar të kuptojnë se si shoqëria jonë arriti këtu ku jemi sot”, thotë Kureishi. “Dhe, duhet të kujtojmë se vitet 1970 ishin pikë kthese në historinë britanike të pasluftës – tregon rrënjët dhe fillimet e gjërave në të cilat po jetojmë tani, si emigracioni dhe familjet e fragmentuara”.

Rice, e cila më parë ishte drejtoreshë artistike e Globit të Shekspirin, shpjegon se ka

gjithashtu shumë paralele politike midis viteve 1970 dhe ditëve të sotme.

“Ashtu si në vitin 1979, jemi në prag të zgjedhjeve të përgjithshme dhe jemi potencialisht në prag të ndryshimit masiv”, thotë ajo, ndërsa Kureishi shton se ndjen se vendi tash është në “gjendje më të dëshpëruar dhe më të keqe sesa në vitet 1970”.

Kureishi dhe Rice kanë punuar së bashku për këtë shfaqje për disa muaj, dhe kjo për Kureishin është veçanërisht e veçantë. Romancieri pësoi lëndimet që ia ndryshuan jetën kur ra kokë në ditën e dytë të Krishtlindjeve më 2022. Pasi nuk mund të përdorte krahët dhe këmbët, Kureishi u trajtua në pesë spitale dhe ky është projekti i parë i madh i shkrimtarit të vlerësuar me disa çmime.

Dyshja flasin pothuajse çdo ditë, por për shkak të gjendjes së Kureishit, ai nuk mund të ndjek personalisht provat apo shfaqjet, ndaj i shikon përmes transmetimit të drejtpërdrejtë.

“Jam i lumtur që mori librin për të bërë çfarë të dojë”, thotë Kureishi për Ricein. “Por, e kam paralajmëruar të mos e ngatërrojë”, shton ai me shaka.

Rice, 57 vjeçe, i thotë Kureishit se ai është “heroi” i saj; thotë se gjëja e bukur në marrëdhënien e tyre të punës është “se rrjeta e gjatë e miqësive njerëzore që eksploron librin, me të vërtetë vazhdon në jetën reale”.

Duke folur për gjendjen e vet,

Kureishi nuk e zbukuron realitetin që po kalon.

“Vuajtjet janë absolutisht të mëdha dhe nuk mbarojnë kurrë, por janë disa avantazhe të kësaj traume”, thotë Kureishi.

Gjëja më pozitive që vjen nga rënia e tij është marrëdhënia e tij me e thellë me djemtë e vet.

“Kam filluar të shkruaj në një mënyrë të re – ua diktoj fjalitë djemve të mi dhe më pas i rishkruajmë së bashku”, shpjegon ai.

Kureishi, i cili po punon për një libër të ri për rënien dhe pasojat e saj, thotë se kurrë nuk e kishte menduar se do të mund të shkruante me dikë tjetër, porse i është dashur të përshtatet.

“Gjëja më e mirë është se tani mund t’i shoh djemtë e mi për çdo ditë – përpara të gjithë bënim jetë të ndara dhe takoheshim herë pas here për një birrë. Tani, bashkëpunimi ynë ka intensitet; kur shkruan je i papërpunuar dhe i ekspozuar dhe unë dhe djemtë e mi duhet të mësohemi me këtë. Po mësojmë më shumë për njëri-tjetrin, për çdo ditë”.

Pavarësisht nga ndikimi shkatërrues fizik dhe emocional i aksidentit, duket se një pjesë e optimizmit dhe shpresës që ndien protagonistin Karim, ka filluar të bie mbi të.

“Emma dhe unë flasim se sa me fat ndihemi – me fat që po e bëjmë këtë shfaqje së bashku dhe gjithashtu me fat që jemi këtu në këtë planet”. //Telegrafi/



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Garuesit e Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnessit të Kosovës arrijnë suksese në Rumani

TIMISOARA, 29 PRILL - Garuesit e Repreracionit të Federatës së Bodybuildingut dhe Fitnessit të Kosovës me sukses të madh i kanë mbyllur garat në Kampionatin Ballkanik në Timisoara të Rumanisë. Arsim Kullashi e ka fituar medaljen e artë në kategori Bodybuilding +100 kg dhe Kampion Absolut në Bodybuilding. Medaljen e Artë në Senior Women

Wellness e ka fituar Arbnora Racaj. Ndërsa Arsim Qiriqi e ka fituar medaljen e argjendtë Muscular Men's Physique, kurse Edona Gashi e fitoi medaljen argjendtë në kategorinë Women Bikini Fitness + 166 cm. Garuesi i pestë që rrëmbeu medalje ishte Metin Soyrtari, i cili fitoi të bronztën në kategorinë Junior Bodybuilding 16-20 vjeç dhe vendi i 6-të në Man's Classic Physique up to 175

cm, kurse Erona Bajrami zuri vendin e katërt, kategoria Women Bikini Fitness -166 cm. Gjithashtu referi ndërkombëtar Bajram Musliu kreu detyrën e vet me sukses dhe komesari i garave Sabri Dragusha. Drejtori sportiv Esat Lata dhe kryetari i Federatës, Fadil Kunushevc, kanë falënderuar Ministrinë e Sportit dhe Komitetin Olimpik të Kosovës.



## Bayern - Real, sonte përballja e parë gjysmëfinale

### "Epoka e re"

MÜNCHEN, 29 PRILL - Pasi eliminuan dy klubet angleze nga Liga e Kampionëve, Arsenalin dhe Manchester Cityn, sonte (e martë) në "Allianz Arena" do të përballen Bayern Muncheni dhe Real Madridi. Kjo ndeshje është në kuadër të ndeshjes së parë të fazës gjysmëfinale. Bayern Munchen e ka humbur garën për titull të kampionit në Bundesliga, gjithashtu është eliminuar nga Superkupa dhe Kupa. Liga e Kampionëve është e vetmja mundësi për ta shpëtuar sezonin klubi më i famshëm gjerman. Në anën tjetër, Real është në një pozicion më të mirë pasi është lider dhe favorit kryesor për titull në La Liga. Klubi i Bayernit në këtë ndeshje vjen pas fitores 2-1 ndaj Eintracht



Frankfurt, kurse golat i shënoi Harry Kane, i cili ka deklaruar: "Fitore e rëndësishme për të mbajtur moralin lart, aq më tepër kur do të zbresim në fushë kundër një prej skuadrave më të forta në

botë, Real Madridit. Të gjithë fatet e sezonit janë të lidhura pikërisht me Ligën e Kampionëve. E pranoj se do të jetë shumë e ndërlikuar karshi Bellingamit me shokë. Kalimi i limiteve do të na

mundësojë arritjen e objektivit. Kështu që jemi gati ta tregojmë veten. Çerekfinalja me Arsenalin demonstroi qartë forcën e grupit. Në këtë trajtë duhet të sillemi edhe nesër në fushë. Mezi po e pres

### Formacionet e mundshme:

**Bayern Munchen:** Neuer; Kimmich, Kim, Dier, Davies; Goretzka, Pavloviq; Muller, Musiala, Gnabry; Kane.  
**Real Madrid:** Lunin; Vazquez, Rudiger, Tchouameni, Mendy; Valverde, Camavinga, Kroos; Bellingham; Rodrygo, Vinicius Junior.

ballafaqimin me Realin dhe atmosferën e zjarrtë në shkallët e stadiumit përpara tifozëve tanë". Fitore në fundjavë ka shënuar edhe Real Madridi në përballje me Real Sociedadin (0-1), derisa të vetmin gol ka shënuar Guler. Bayernit në këtë ndeshje i mungojnë Leroy Sane, Serge Gnabry, Dayot Upamecano dhe Kingsley Coman, kurse Real do të jetë vetëm pa Courtois dhe David Alaban.

## Hyseni për herë të pestë fiton çmimin 'Ylli i javës'



PODUJEVË, 29 PRILL - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 31-të në Albi Mall Superligë i është dhënë dhënë futbollistit Muhamet Hyseni. Çmimin "Ylli i javës" për Hysenin e dha Shpat Ibrani, menaxher i marketingut në Albi Online. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit në përbërje: Skënder Krapa, Fatmir Mehmeti dhe Fisnik Ademi.

Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i javës" për xhiron e 31-të t'i takojë Muhamet Hysenit, i cili shënoi dy gola në fitoren e skuadrës në udhëtim kundër Prishtinës, që e mban në hap për kreun e tabelës dhe arrit të rikthehet në pozitën e golashënuesit më të mirë të Albi Mall Superligës me gjithsejtë 21 gola të realizuara. Pasi mori këtë çmim, Hyseni shprehi lumturi që u vlerësua më i miri i javës. "Ndiem jashtëzakonisht mirë pasi që për herë të pestë shpallëm

"Ylli i javës", çmim ky që vjen pas paraqitjeve shumë të mira në vazhdimësi të të gjithë ekipit. Kjo po më ndihmon edhe mua të realizoj gola dhe ta fitoj këtë çmim. Te Llapi kemi një atmosferë fantastike dhe jemi shumë të bashkuar. Besoj se do ta mbyllim sezonin me trofeun e kampionit që e kemi synim. Na mbetet që edhe këto pesë ndeshjet e fundit ta japim maksimumin dhe t'i gëzojmë të gjithë tifozët llapjanë dhe 'Legjendat', ka thënë Hyseni për faqen zyrtare të FFK-së.

## Thaqi: Nuk jemi në bisedime me Gripshin dhe Krasniqin

Suharekë, 29 prill - Në derbin e fazës gjysmëfinale të Kupës së Kosovës në Futboll ndërmjet Ballkanit dhe Suharekës, ndër të tjera, vëmendjen e mori edhe një detaj mjaft interesant. Në rrethojat e stadiumit u shfaq një fotografi e yllit të Ballkanit, Nazmi Gripshi, me fanellën e

Suharekës, duke ngjallur kështu spekulime se ai mund të bëjë një lëvizje befasuese te rivali i Ballkanit në afatin kalimtar të verës. Rreth kësaj ka folur për "KosovaPress" trajneri i Suharekës, Arsim Thaqi. Ai ka mohuar që skuadra të ketë nisur bisedimet për transferimin e

Gripshit, edhe pse nuk e ka fshehur dëshirën ta kishte atë në skuadrën e tij. "Unë dhe secili trajner do të kishim dëshirë ta kishim Gripshin në ekip, sepse vërtet ka treguar cilësi të jashtëzakonshme me Ballkanin, por nganjëherë gjërat varen edhe nga lojtari dhe rrethanat e

tjera jo vetëm prej dëshirës së trajnerit apo klubit. Kështu që ajo që është e vërtetë duhet të deklaroj se nuk besoj asnjë prej klubit tonë, as për Gripshin, por Endrit Krasniqi që ka dalë se ka filluar negociatën me Suharekën, nuk ka asnjë lojtar që ka filluar negociatën me Suharekën dhe



nuk besoj që do të fillojë pa përfunduar kampionati", ka thënë Thaqi.



## Rapidi kërkon mbi 3 milionë euro për Krasniqin

**BUKURESHT, 29 PRILL** - Rapidi mund të humbasë një nga lojtarët më të rëndësishëm në skuadër në fund të këtij sezoni. I transferuar nga Rapidi në fillim të këtij viti, Ermal Krasniqi mund të largohet nga kjo skuadër në verë. Kosovari është

shumë pranë një transferimi në Bundesligë, raportojnë mediet në Rumani. "Rapidi ka marrë një ofertë për transferimin e Krasniqit. E kemi fjalën për Werder Bremenin, vendin e 10 në Bundesligë. 'Rapidistët' kërkojnë për Ermal Krasniqin 3

milione euro plus një përqindje prej 20 % për një transferim të mundshëm. Të shohim nëse palët arrijnë marrëveshje", ka thënë Horia Ivanoviçi për gazetën "FANATIK". Krasniqi për momentin vlerësohet 1.5 milion euro, sipas

"Transfermarkt". Nëse ai largohet për në Werder Bremen, tarifa e transferimit prej 3 milionë eurosh e kërkuar nga zyrtarët e Rapidit mund t'i ndihmojë ata të ndërtojnë një ekip që do të luftojë për titull sezonin e ardhshëm.



## 9 tituj në 12 vjet, Al Khelaifi 'pushton' Francën, tani ëndërron 'triple tën'

**PARIS, 29 PRILL** - Një titull nga divani nuk ka të njëjtën shije, aq më tepër për një skuadër si PSG-ja që e ka kthyer në monopol këtë garë në Francë. Lyoni mposhti Monacon duke bërë që Parisi të shpërthente në festë për këtë titull të 12 në histori. Kjo ishte hera e nëntë që kur sheiku Al Khelaifi zbarkoi në Francë që PSG feston për titullin kampion, 9 tituj në 12 vjet tregojnë qartë atë që Al Khelaifi ka bërë për këtë ekip. "Të fitosh titullin është fantastike, por të fitosh Ligën 1 për herë të 12 është diçka speciale për ata që janë të lidhur me këtë klub. U bëj komplimentet e mia lojtarëve, trajnerit Luis Enrique dhe stafit për këtë titull. Që në fillim të këtij sezoni ekipi u shfaq i bashkuar. Ta shijojmë këtë moment si një familje dhe ta vijojmë punën, ndeshje pas ndeshje, deri në fund



të sezonit", u shpreh Al Khelaifi. Pas suksesit në Spanjë, Luis Enrique shijon edhe titullin e parë në Francë, me një dominim absolut, teksa u shpall kampion me 12 pikë dallim 3 javë përpara fundit. Kylian Mbappe largohet

si triumfator nga Franca, me titullin në "xhep", por Mbappe dhe pjesa e tjetër e ekipit nuk dëshirojnë të ndalen këtu pasi janë në garë edhe për dy trofetë e tjerë, Kupë dhe Ligën e Kampionëve.

## Minnesota, gjysmëfinalistja e parë e 'play-off'-it, lakersat rihapin garën



**MINNESOTA, 29 PRILL** - Minnesota bëhet ekipi i parë gjysmëfinalist i "play-off"-it në NBA këtë sezon. Skuadra e Wolvesit fitoi me rezultat 122-116 ndaj Phoenixit, duke fituar 4-0 serinë e çerekfinaleve. Anthony Edwards me 40 pikë ishte lider në fushë për Minnesotan, ndërsa 82 pikët e dyshes Durant - Booker mbetën për statistikë. Rihap garën për një vend në

gjysmëfinale ekipi i lakersave, që në fushën e tij fitoi me rezultat 119-108 ndaj kampionëve të Denverit. Jokiçi realizoi sërish një "triple double", me 34 pikë, 14 rebounde e 14 asistime, por që s'mjaftuan. LeBron Jamesi me 30 pikë, Davisi me 25 pikë e 23 rebounde si dhe Reaves e Russell me nga 21 pikë secili ua dhanë fitoren lakersave.

Barazim 2-2 me ndeshje mes clippersave dhe Dallasin, me kalifornianët që fituan me rezultat 116-111. Harden dhe George realizuan nga 33 pikë secili për clippersat, duke i bërë të pavlefshme 40 pikët e Irvingut për teksanët. Fitoi edhe New Yorku, 97-92 në fushën e Philadelphia's, ndeshje ku u dallua Brunsoni me 47 pikë e 10 rebounde.

### ÇEREKFINALET - KONFERENCA E LINDJES

Cleveland - Orlando	(2-2)
New York - Philadelphia	97-92 (3-1)
Boston - Miami	(2-1)
Milwaukee - Indiana	113-126 (1-3)

### ÇEREKFINALET - KONFERENCA E PERËNDIMIT

Minnesota - Phoenix	122-116 (4-0)
Denver - Lakers	108-119 (3-1)
Clippers - Dallas	116-111 (2-2)
Oklahoma - New Orleans	(3-0)

## Silva konfirmon largimin nga Chelsea

"Divorci" mes Thiago Silvas dhe Chelseas tashmë është zyrtar. Mbrojtësi i kombëtares braziliane ka bërë me dije përmes një videoje të publikuar në faqen zyrtare të Chelseas se do të largohet nga londinezët më

30 qershor, kur i skadon kontrata. "Chelsea do të thotë shumë për mua. Erdha për të qëndruar vetëm një vit dhe përfundova duke qenë pjesë e kësaj skuadre për katër vjet. Fëmijët e mi të luajnë për

Chelsea është krenari e madhe të jesh pjesë e kësaj familjeje. Shpresoj që ata të vazhdojnë karrierën e tyre këtu, në një klub ku të gjithë do të donin të ishin. Në katër vitet e mia këtu kam dhënë gjithmonë gjithçka. Por,

për fat të keq, çdo gjë ka një fillim, një mes dhe një fund. Nuk do të thotë se kjo është përfundimtare. Unë e lë ende derën hapur. Shpresoj që në një të ardhme të afërt të jem në gjendje të kthehem, qoftë edhe

në një rol tjetër. Dashuria që ndiej është e papërshkrueshme. Përsëritjet janë për ata që largohen dhe nuk kthehen, por unë kam ndër mend ta rikthehem një ditë", ka thënë Silva.

### SHKURT

#### Aro Muriq sërish në formacionin e javës në Premierë Ligë

Arijanet Muriq ka vazhduar shkëlqimin në elitën e futbollit anglez Ligën Premierë edhe në xhiron e 35-të. Portieri nga Kosova ishte i jashtëzakonshëm në barazimin që Burnley e mori në udhëtim te Manchester Unitedi. 25-vjeçari bëri hiq më pak se nëntë pritje, duke marrë notën 8,6, që ishte edhe më e larta nga radhët e futbollistëve të Burnleyt. Falë paraqitjes fantastike në "Old Trafford", Aro ka zënë vend në formacionin e xhiros së 35-të në Ligën Premierë nga "SofaScore". Në mbrojtje janë James Tarkowski, Burn dhe Josko Gvardiol, derisa mesfusha përbëhet nga yje si Bukayo Saka, Bruno Fernandes, Kevin de Bruyne dhe Andy Robertson. Në sulm janë Noni Madueke i Chelseat, Alexander Isak i Newcastle United dhe Luiz Diaz i Liverpoolit.

#### Avdijaj në formacionin e javës në Austri

Donis Avdijaj ka vazhduar shkëlqimin në elitën e futbollit austriak me skuadrën e tij TSV Hartberg. Ylli nga Kosova ka qenë fantastik të dielën në mesditë, ku ishte më meritori për fitoren e skuadrës së tij TSV Hartberg 3-2 ndaj Austria Klagenfurt. Avdijaj ishte i pandalshëm për mbrojtjen mysafire duke arritur të realizojë het-trik në këtë sfidë për t'i dhënë tre pikë shumë të rëndësishme skuadrës së tij. Sulmuesi dardan mori notën 9,8 nga "SofaScore" dhe është futur në formacionin e javës në elitën e futbollit austriak. Formacioni: Stejskal, Andrade, Bacher, Strauss, Flecker, Pass, Kainz, Avdijaj, Seidel, Ljubiqiq, Gloukh.

#### Arteta: Do të luftojnë deri në fund për titull

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, u shpreh i bindur se ekipi i tij do të luftojë deri në fund për titullin e kampionit në Premierë Ligë. "Jam i sigurt 100 % për këtë, djemtë do të luftojnë deri në fund. Ata besojnë ndeshje pas ndeshje, minutë pas minute, janë të motivuar. Ne do ta provojmë deri në fund", ka thënë Arteta. Arsenali të dielën e mposhti Tottenhamin me rezultat 2-3. Aktualisht është në vendin e parë me një pikë më shumë se Manchester City, por me një ndeshje më pak të zhvilluar.

#### Joshua: Usyk do të jetë fitimtar ndaj Furyt

Anthony Joshua ka bërë një parashikim të guximshëm se kush do ta fitojë përballjen mes Tyson Furyt dhe Oleksandr Usykt. Më 18 maj dy kampionët e peshave të rënda do të dalin në ring në Arabinë Saudite për ta përcaktuar fituesin. Fury do ta mbrojë titullin e tij në WBC, ndërsa Usyk do të vendosë titujt e tij në WBA, WBO dhe IBE. Duke folur përpara meçit, Joshua ka bërë parashikimin e tij se kush do ta fitojë luftën. "Kam luftuar me Usyktun, kështu që mund të flas vetëm për atë që kam përjetuar me të - një luftëtar fenomenal, do të thosha se do të bëjë një punë vërtet të mirë", ka deklaruar ai për "TalkSport". "Unë kurrë nuk kam luftuar me Furyt, kështu që nuk mund të flas se si është të përballësh me të. Vetëm duke folur për atë që di, më duhet të them se Usyk do të jetë fitimtar". Joshua ka humbur dy herë nga Usyk në pikë dhe është kritikuar shumë për paraqitjen e tij në ndeshjen e parë. Fituesi mund të përfundojë përballë ish-kampionit Joshua, i cili, gjithashtu, ka zbuluar listën e tij të ngushtë për ndeshjet e ardhshme. Mbetet për t'u parë se kush do të dalë fitimtar, por me më pak se një muaj deri në mbrëmjen e ndeshjes, AJ ka dhënë parashikimin e tij.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

# Lumë's Details

## Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gani Veseli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Dr. Ali Sokoli" ish "9 Maji" Prishtinë.
- Arben Pnishi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e sh.m.e. "Kadri Kusari".
- Emir Kerco shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Lidhja e Prizrenit " Prizren.
- Besnik Sula shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Nedziba Aslani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Meto Bajraktari " Recane.
- Njomza Dervishaj nga Rracaj e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 6-9 e lëshuar nga shkolla fillore e mesme e ultë "3 Dëshmorët", Sheremet-Gjakovë.
- Pjetër Berisha nga Korenica e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës 1-8 e lëshuar nga shkolla fillore "Luigj Gurakuqi", Korenicë-Gjakovë.
- Floriana Gashi nga Roga e Gjakovës, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të klasës 1-5 dhe 6-9 të SH.F.M.U "Haxhi Hoti", Rogovë.
- Arben Hoti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.T "Nexhmedin Nixha", drejtimi MEKANIK, Gjakovë.
- Enise Shuki shpall të pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Motrat Qiriazit " Prizren.
- Bejadin Dervishaj shpall të pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Jashar Krasniqi nga Damjani KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shkollës fillore Kongresi i Manastirit Damjan KK Gjakovë.
- Astrit Tahiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.
- Alban Meta nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë prej klasës 1-8 të shkollës fillore "Selman Riza", Gjakovë.
- Fatlinda Gjurar nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm të mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.
- Bekim Veljiji shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Leke Dukagjini " Prizren.
- Nexhmedin Tulla shpall te pavlefshme diplomën Q.K. "11 Marsi" Prizren.
- Lavdije Sopi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Zef Lush Marku " Velezhe.
- Zylmi Krasniqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K . "11 Marsi" Prizren.
- Edita Beqa nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Xhavit Januzi nga Nivokazi KK Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.t. Bujqësi " Nexhmedin Nixha" Gjakovë.
- Fisnik Nixha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11. të sh.m.t. "Nexhmedin Nixha" Gjakovë, Elektroteknik.
- Kingj Nikolla nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.e. " Kadri Kusari" Gjakovë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

